



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-klina.org

Kuvendi i Komunës Klinë

01Nr. 06-19474 /2025

Datë: 30, 06 /2025

Duke u mbështetur në nenin 17 shkronjën a), nenin 40 paragrafi 40.2 shkronjën b) dhe c) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Ligjin Për Financat Publike dhe Përgjegjësitë nr.05/L-007 i ndryshuar dhe plotësuar Nr.03/L-048 , sipas Qarkores buxhetore 2026/01, nenit 40 paragrafi 2. Pikën 2 të Statutit të Komunës së Klinës, me rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa të datës 09.06.2025 si dhe pas dëgjimeve të mbajtura me publikun, Kuvendi i Komunës së Klinës në seancën e VI-të të rregullt për vitin 2025, të mbajtur më 27.06.2025 mori këtë:

V E N D I M

Për miratimin

E Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB) për periudhën 2026-2028 për Komunën e Klinës

1. Miratohet Korniza Afatmesme Buxhetore Komunale për periudhën 2026-2028 si në vijim:

Korniza afatmesme buxhetore 2026-2028	Buxheti aktual 2025	Planifikimi 2026	Vlerësimi 2027	Vlerësimi 2028
Granti i përgjithshëm	6,571,819.00	6,571,819.00	6,960,367	7,513,860
Granti specifik i arsimit	5,953,349.00	6,180,993.00	6,366,422	6,557,415
Granti i shëndetësisë	1,897,981.00	1,884,302.00	1,940,831	1,999,056
Të hyrat vetanake	1,495,504.00	1,551,784.00	1,662,711	1,669,206
Financimi për shërbimet rezidenciale	250,000.00	150,000.00	200,000	200,000
Totali :	16,168,653.00	16,338,898.00	17,130,331.00	17,939,537.00

2. Hartimi dhe miratimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore përbën një detyrim për institucionet buxhetore komunale, kërkuar me Qarkoren Buxhetore Komunale 2026/01 të lëshuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transferëve në pajtim me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (LMFPP).
3. Pjesë përbërëse e vendimit është Korniza Afatmesme Buxhetore 2026-2028 për Komunën e Klinës.
4. Vendimi hynë në fuqi pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës, bazuar në Ligjin Nr.08/L-284, si dhe pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës.

Njoftohen:

- *MAPL;*
- *Kryetari i Komunës;*
- *Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim;*
- *Zyra për Informim;*
- *Arkivi.*

